REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
REKTORI

Nr. 2450 **prot.** **Korçë, më** 17 . 11 . **2026**

Lënda: Shpallje e thirrjes për vetëkandidim për tre anëtarë akademikë, kategoria "Profesorë", të Komitetit të Etikës në Kërkimin Shkencor

NJËSIVE KRYESORE TË UNIVERSITETIT "FAN S. NOLI", KORÇË

Në zbatim të nenit 31, të ligjit nr. 109/2024 "*Për shkencën dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë*"; të VKM-së nr. 831, datë 30.12.2025; si dhe të nenit 26, pikat 1, 2, 3 dhe 4, të Kodit të Etikës për Kërkimin Shkencor, Universiteti "Fan S. Noli", shpall thirrjen për vetëkandidim për 3 (tre) anëtarë të personelit akademik në Komitetin e Etikës në Kërkimin Shkencor.

Kushtet e kandidimit

Kandidati duhet të jetë pjesë e personelit akademik të Universitetit "Fan S. Noli" dhe t'i përkasë kategorisë "Profesor".

Anëtari i Komitetit, nuk mund të jetë njëkohësisht anëtar i Senatit Akademik, i Bordit të Administrimit ose i Këshillit të Etikës të Universitetit dhe nuk mund të mbajë funksion drejtues akademik (Rektor, Zëvendësrektor, Dekan, Zëvendësdekan, Drejtues i Njësisë Bazë).

Paraqitja e kandidaturave

Personat e interesuar të paraqesin në Zyrën e Protokollit të Universitetit "Fan S. Noli", brenda datës 15.12.2026, dokumentacionin e mëposhtëm:

• Kërkesë me shkrim për vetëkandidim, drejtuar Rektorit;

• Jetëshkrim (CV) të përditësuar;

• Dokument që vërteton kategorinë akademike "Profesor";

• Deklaratë të nënshkruar për mungesën e papajtueshmërive.

Pas përfundimit të afatit dhe verifikimit të përmbushjes së kushteve, kandidaturat i paraqiten Senatit Akademik për zgjedhjen e tre anëtarëve.

Mandati është 3 (tre) vjet, me të drejtë rikandidimi vetëm një herë.

REKTORI

Prof. dr. Lorenc Ekonomi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË-U.
KORÇË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI"